



Datë: 28.03.2025
Numër Protokolli: 3334/2025

A.nr.384/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.384/2025, të datës 28.02.2025, të parashtruar nga ankuesja D.M., kundër organit të punësimit/Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.384/2025, e datës 28.02.2025, e parashtruar nga ankuesja D.M.

A r s y e t i m

Ankuesja D.M. (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 28.02.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me atë së kategorizimi i pozitës Lektor nuk është në përputhje me aplikimin e pozitave të njëjtat përgjatë sektorit publikë, duke kërkuar që të bëhet në një kategorizim më të larë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 05.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Akademia e Kosovës për Siguri Publikë (*tutje AKSP*), ndërsa kjo e fundit më datë 07.03.2025 ka përcjellë fare përgjigje në ankesë.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesit, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 115/1 të datës 06.09.2011, është e punësuar në pozitën e punës Lektor në AKSP. Tutje e njëjta fillimisht 26.12.2023, ka parashtruar një kërkesë për shqyrtim tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë për kategorizim nga klasa profesional 2 në klasën profesional 1, e të cilën e ka adresuar tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, ndërsa më datë 26.12.2023 ka kërkuar nga Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që kërkesën e saj të adresoj tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Duke qenë se ankuesja pretendon se nuk ka marr përgjigje në kërkesat e saj, më datë 13.02.2025 i është drejtuar me kërkesë Komisionit për Ankesa në AKSP, mirëpo Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, më datë 14.02.2025 ka njoftuar ankuese së Komisioni i Ankesave pran AKSP shqyrton vetën ankesat e nëpunësit të shërbimit publik dhe teknik e mbështetës duke e udhëzuar që

lidhur me pretendimet të parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së kategorizimi i pozitës së saj në profesional 2, nuk është i drejtë, duke pretenduar se duhet të kategorizohet në kategori më të lartë dhe atë edhe me koeficienti, gjegjësisht në klasën profesionale 1 me koeficient 5.7.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me theks të veçantë nën 2 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nën 4 paragrafi 3 ku parashihet se: ” **Neni 2:** 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, **Neni 14:** 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik...” referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht AKSP, fillimisht në vitin 2022 përmes grupit punues për vlerësimin dhe klasifikimin e pozitave të punës sipas raportit të datës 16.12.2022, kishte bërë një klasifikimin të pozitave ku pozitën e ankueses e kishin klasifikuar në kategorinë profesionale klasa profesional 2, mirëpo që ky klasifikimin nuk ka marr miratimin siç thuhet edhe në përgjigjen në ankesë të datës 07.03.2024. Marr parasysh akt emërimit e ankueses Kolegji i Këshillit, konstaton se procedimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë e që sipas listës së pagave ankuesja rezulton se paguhet sipas koeficientit I15, 5.1.

Kolegji i Këshillit, konstaton se AKSP nuk ka përfunduar klasifikimin e vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshme nga data 28.02.2024, rrjedhimisht me nën 34 të kësaj rregullore përcaktohet se: **Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje**, dhe po ashtu, edhe me Vendimin me Nr.08/226, të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, më pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: **Obligohen të gjitha institucionet që të përfundojnë Klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog**, ndërsa, më pikën 3 është shfuqizuar pika 3 dhe 4, e Vendimit Nr. 04/128, të datës 16 shkurt 2023 të Qeverisë së Kosovës, pika këto që i referoheshin detyrimit të Ministrisë së Financave/Thesarit të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme/Departamentit për menaxhimin e zyrtareve publik për ekuivalentim të koeficienteve dhe korrigjimeve. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, vlerëson se pa pasur fillimisht klasifikimin e vendeve të punës bazuar në këtë rregullore dhe vlerëson se ankesa e parashtruar nga

ankuesja, për kategorizimin e pozitës së saj është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, e si e tillë e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, si pasojë e përcaktimeve ligjore si më lartë, dhe duke qenë së AKSP ende nuk e ka të përfunduar klasifikimin e vendeve të punës, Kolegji duke u bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjore për sigurimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil rikujton Drejtorin e Përgjithshëm të AKSP që ndërmerr të gjitha veprimet në atë mënyrë që të përfundohet klasifikimi i vendeve të punës për zyrtarët publikë të punësuar në këtë institucion në pajtim me kërkesat ligjore.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.384/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses D.M.;
- Organit të punësimit: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në AKSP; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.